



BASHKIA MIRDITË

Nr. 541 Prot.

Rrëshen, më 07.02.2024

L e n d a : Dërgojmë “Njoftim për publikim vende të lira pune “Polic bashkiak” në faqen Tuaj.

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Adresa : Bulevardi “B.Curri”, pranë ish – “Hotel Arbana”

TIRANË

Bashkëngjitur Ju dërgojmë “Njoftim për publikim”, për t’i publikuar në faqen tuaj Ëebsite. Bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 89 dt.22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”, Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Vendimit nr. 452 datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”, Vendimit nr.2.datë.08.01.2024 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për Vitin Buxhetor 2024,

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI

ALBERT MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË

Nr. 541 Prot.

Rrëshen, më 07.02 2024

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE PËR “POLIC BASHKIAK” BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 89 dt. 22.12.2022 “Për Policinë Bashkisë”, Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Vendimit nr. 452 datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”, Vendimit nr.2.datë.08.01.2024 “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për Vitin Buxhetor 2024”,

Bashkia Mirditë shpall vende të lira pune në pozicionin:

13-Trembëdhjetë vende të lira pune ‘Polic Bashkiak’ – Bashkia Mirditë

Kriteret për pranimin në Policinë Bashkiake të çdo personi janë si më poshtë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar.
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- ç) Të ketë përfunduar arsimin e mesëm.
- d) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale.
- dh) Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- e) Të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit.
- ë) Të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesën për punësim
- b) Jetëshkrimin
- c) fotokopjen e kartës së identitetit
- d) fotokopjet e noterizuara të dëftesës së shkollës së mesme.
- e) 2 (dy) foto me përmasa 4 x 6 cm

- f) raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore
- g) certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti)
- h) vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale
- i) vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykimi
- j) dokumentet për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës
- k) vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike
- l) vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- m) vërtetimin që të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës, për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi
- n) vërtetimin e besueshmërisë që lëshohet nga struktura vendore e Policisë së Shtetit, me kërkesën e bashkisë përkatëse, përpara pranimit në Policinë Bashkiake.
- o) Lista e dokumentave të sipërcituar të jetë e inventarizuar dhe e nënshkruar nga kandidati.

Dorëzimi i dokumentacionit duhet të bëhet pranë protokollit në Bashkinë Mirditë, brenda datës **13.02.2024**.

Secili individë që plotëson kushtet dhe kriteret e veçanta për konkurim në policinë bashkiake do njoftohet me email dhe me telefon për ditën dhe orën e testimit. Gjithashtu shpallja do afishohet edhe në ambjentet e dukshme para bashkisë.

Bashkia Mirditë